

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



Imam Sejid Ali Khamenei

ARROGANCA GLOBALE

Tiranë, 2020

Titulli i librit: Arroganca Globale

Autori: Imam Sejid Ali Khamenei

Përktheu: Vullnet Merja

Redaktoi: Jerida Kulla

Faqosja & Kopertina: Sabrie Feza

Botues: Shoqata FLLADI

بسم الله الرحمن الرحيم

Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit!

HYRJE

Bota islame po vuan sot nga përpjekjet e të tjerëve që dëshirojnë të sundojnë mbi pasurinë e saj, që të vendosin ata për fatet e tyre.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*), këtë përpjekje të tyre, e ka quajtur “arrogancë botërore”. Ky term përfshin të gjithë ata që përpiqen për të realizuar një gjë të tillë.

Çfarë është arroganca? Cilat janë qëllimet e saj? Cilat janë rrugët dhe mënyrat që ndjekin për sundimin e botës islame?

Këto dhe pyetje të tjera, ne do të përpiqemi t’u përgjigjemi në këtë broshurë, duke ndjekur dhe duke u udhëhequr nga udhëzimet e dhëna nga Kujdestari dhe Prijësi i çështjeve të myslimanëve, Imam Khamenei (*Allahu*

i dhëntë jetë të gjatë!). Ne do të përfitojmë prej predikimeve të tij në lutjet (namazin) e xhumasë dhe takimet me të.

Lusim Allahun e Madhëruar të na bëjë të qëndrueshëm dhe të fortë përballë arrogantëve. Të na bëjë prej atyre që janë të bindur ndaj shtetit dhe prijësve të tyre, si dhe prej atyre që janë pranë Zotit, duke ecur nën hijen dhe Rrugën e Tij. Me të vërtetë, Zoti është dëgjuesi i lutjeve dhe u përgjigjet atyre.

Shoqata kulturore “Dituria islame”

E VËRTETA MBI ARROGANCËN

- Çfarë është arroganca?
- Vështrim mbi arrogancën në botë
- Arroganca dhe konflikti global
- Arroganca dhe masakrat
- Çfarë fshihet pas arrogancës?
- Përmbledhje e çështjes
- Qëllimet e arrogancës globale

ÇFARË ËSHTË ARROGANCA?

Arroganca është një fjalë e marrë nga mendjemadhësia që do të thotë të qëndruarit mbi të tjerët. Koncepti i arrogancës, në vetvete, nuk është i ri, nuk është shfaqur në kohën tonë. Përkundrazi, është një çështje e vjetër dhe e lashtë sa vetë historia. Allahu i Madhëruar, në Kur'anin Fisnik, ka përmendur shembuj të arrogantëve. Një prej tyre ishte Faraoni.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Pastaj, Faraonit dhe parisë së tij pas tyre, u dërguam Musain dhe Harunin me mrekullitë Tona, por ata u sollën me mendjemadhësi, sepse ishin popull keqbërës. Kur u erdhi e Vërteta prej Nesh, ata thanë: ‘Kjo duket që është magji e qartë!’”**

“Musai tha: ‘A mos vallë, për të Vërtetën, pasi ju ka ardhur, thoni: Kjo është magji? E pra, magjistarët nuk shpëtojnë!’”

“Ndërsa ata thanë: ‘A mos ke ardhur të na kthesh nga ajo (rrugë), ku i kemi gjetur etërit tanë e, ju të dyve, t’ju takojë pushteti në Tokë? E pra, ne nuk duam t’ju besojmë ju të dyve!’”¹

¹Sure “Junus”, ajetet 75-78.

Në qoftë se arroganca gjendet te një person, atëherë ajo është një nga cilësitë e dënueshme etike dhe morale. Edukatorët dhe dijetarët e etikës e kanë klasifikuar atë si një nga tiparet shkatërruese të fesë.

Imam Bakiri (*Paqja e Zotit qoftë të!*) ka transmetuar: *“Lavdia i takon vetëm Allahut. Edhe kryelartësia i takon vetëm Atij. Kushdo që dëshiron të krenohet para Zotit, Allahu do ta poshtërojë në Xhehenem”*.²

Në një transmetim nga Ebu Xhaferi dhe Ebu Abdullahu (*Paqja qoftë mbi ta!*), lexojmë: *“Nuk do të hyjë në Xhenet ai që në zemrën e tij ka qoftë edhe një grimcë arrogancë”*.³

Gjithashtu, ai thotë se një nga detyrat më të mëdha të njeriut është që ta kërkojë dijen kudo ku ajo ndodhet, por brenda kufijve ligjorë dhe jo t’i kapërcejë ata. Shkelja e kufijve nuk është gjë tjetër veçse shfaqje e tiranisë dhe e arrogancës, duke përfshirë këtu edhe imazhin e shëmtuar dhe të turpshëm që ato sjellin. Rreziku më i madh për një person vjen atëherë kur ai mbërthehet nga tirania dhe arroganca.

²Shejkh El Kulejni, “El Kafij”, vëll. 2, f. 309.

³Shejkh El Kulejni, “El Kafij”, vëll. 2, f. 310.

Duhet të dihet se kjo është një fatkeqësi që mund t'i përfshijë të gjithë.⁴

Përkufizimi i këtij termi është përdorur në këtë epokë për shtetet që përpiqen të sundojnë botën.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Arroganca globale përfshin të gjitha forcat sunduese në botë dhe të gjitha fytyrat e paturpshme që sundojnë popujt”.⁵

⁴ Me rastin e Bajramit të Madh, fillimi i muajit Sheual 1422 Hixhri, Teheran.

⁵ Me rastin e përkujtimit të vitit të shtatë të udhëtimit të Imamit, 16 Muharrem 1417 Hixhri.

⁶ Me rastin e përkujtimit të vitit të shtatë të kalimit nga kjo jetë e Imam Khomeinit, 1 Rebiul Euel 1421 Hixhri, Teheran.

VËSHTRIM MBI ARROGANCËN NË BOTË

Shtetet arrogante i shohin vendet e tjera në mënyrë përbuzëse dhe inferiore. Ato përpiqen me të gjitha mënyrat dhe format që ta paraqesin veten e tyre në media të ndryshme me ide, me pamje dhe përshtkrim shembullor, si dhe të portretizojnë të tjerët në një stad të ulët prapambetjeje. U tregojnë atyre se kanë nevojë për një periudhë të gjatë, që të zhvillohen dhe të arrijnë nivelin e tyre ekonomik. Qëllimi i gjithë kësaj taktike të këtyre vendeve, shpjegohet nga Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*).

Ai na tregon se ajo është: Mbjellja e dëshpërimit dhe e mërziisë në shpirtrat e dobët, si dhe shkaktimi i disfatës psikologjike te popujt.

Në rast se do të shihni peizazhin gjeografik të botës, si dhe praktikat e ndarjet e saj politike, do të gjeni se cilët janë ata që kanë pushtuar vendet dhe gjithçka në tokë. Do të gjeni ata që shikojnë me përbuzje të gjithë popujt, si dhe kontrollojnë padrejtësisht dhe në mënyrë armiqësore burimet njerëzore dhe materiale. Ato janë fuqitë e arrogancës. Por, ku bazohen dhe mbështeten ata?

Ata u sugjerojnë popujve se fuqia e tyre është një forcë e padiskutueshme”.⁶

Gjendja ka arritur deri aty, sa disa vende arrogante u drejtohen të tjerëve me gjuhën e skllevërve, ose të shërbëtorëve. U sugjerojnë dhe i tregojnë botës se janë ata që i zotërojnë këto shtete të vogla.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*), në lidhje me këtë çështje, thotë:

“Realisht, është diçka e rrallë që një person të gjejë një qeveri që të flasë njësoj si qeveritë arrogante që flasin për vendet e Lindjes së Mesme. Ata i konsiderojnë këto vende si prona të vetat. Kjo do të thotë arrogancë”.⁷

⁷ Me rastin e përkujtimit të pushtimit të Ambasadës amerikane, 29 Shaban 1423 Hixhri, Teheran.

ARROGANCA DHE KONFLIKTI GLOBAL

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) i referohet një çështje shumë të rëndësishme. Ai përqendrohet te shkaku i konfliktit në botë. Ky shkak gjendet gjithmonë te lakmia e njerëzve arrogantë, të cilët përpiqen të kontrollojnë popujt në botë dhe të vendosin për fatet e njerëzve, sipas interesave dhe dëshirave të tyre personale.

Ai thotë: “Konfliktet që ndodhin në botë, qoftë në të kaluarën, në të tashmen, apo në të ardhmen, shkaktohen nga fakti që fuqitë arrogante kërkojnë të përcaktojnë fatin e popujve, ashtu siç ato dëshirojnë”.⁸

⁸ Me rastin e Ditës së Mësuesit, 3 Dhul Hixhheti 1415 Hixhri, Teheran.

ARROGANCA DHE MAŠAKRAT

Nuk është aspak për t'u habitur, kur ne shohim gjurmët e duarve të shteteve arrogante në masakrat e kryera kundër popujve të pafuqishëm e të pambrojtur. Për ta, kjo është e natyrshme. Vërejmë me kujdes vendet arrogante, të cilat çdo ditë përmendin dhe ngrenë lart të drejtat e njeriut, të drejtat e grave dhe të drejtat e kafshëve. E vërteta është se në sytë e tyre nuk ekziston asnjë vlerë për personin tjetër, vetëm në atë masë që të arrijnë interesat e tyre.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Kudo që të shihni një masakër kundër myslimanëve, do të gjeni praninë e drejtpërdrejtë të vendeve arrogante, ose nxitjen prej saj, ose heshtje që nënkupton qartë nxitjen”.⁹

Përballja dhe veprimi me standarde të dyfishta, në lidhje me çështjet humanitare, është më se i qartë për të gjithë popujt e pafuqishëm të botës. Në Shtetet e Bashkuara dhe në korridoret e Këshillit të Sigurimit zhvillohen diskutime për një plagë të hapur, sikurse është pushtuesi sionist në Liban dhe Palestinë. Shtetet arrogante heshtin,

⁹ Ramazan viti 1414 Hixhri, Teheran.

kur sionistët bëjnë masakra në Kana dhe Xhenijn. I shikonim ata të flisnin për mungesën e demokracisë dhe të burgosurit politikë në botën arabe. Ndërkohë gjithkush mund të shohë shenjat e para të demokracisë në Abu Garijb dhe Guantanamo.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Forcat e Shejtanit, ato që konsiderohen shtete arrogante dhe që i përfaqëson Amerika, kanë demonstruar se janë kundër njerëzimit dhe vlerave njerëzore. Jetët dhe shpirtrat e mijëra njerëzve nuk kanë asnjë vlerë për ta. Ju jeni dëshmitarë se si Izraeli, brenda një periudhe pesëmbëdhjetë ose gjashtëmbëdhjetë ditësh, vrau, plagosi dhe zhvendosi dhjetëra mijëra njerëz. Shkaktoi mjerim, pa iu dridhur qerpiku prej botës arrogante, pajisjet e të cilës ai i përdor. Ndërkohë i shikon ata të shpenzojnë shuma të mëdha parash për të shpëtuar jetën e një maceje që ra në gropë, edhe pse është një kafshë”.¹⁰

Një nga shembujt më të mëdhenj të masakrave të kryera nga arroganca globale është pushtimi i tokave të popullit palestinez dhe krijimi i një shtetit sionist në rrënojat e tij. Ky është modeli më i keq që mund të imagjinojmë nga format e arrogancës, pasi është i përzier me kolonializmin.

¹⁰ Dita e Punëtorëve dhe Dita e mësuesit, 12 Dhul Hixhaxheti 1416 Hixhri, Teheran.

Ajo është një masakër kundër të drejtës së një populli të tërë që meriton të jetojë i lirë dhe i pavarur.

Në lidhje me këtë formë skandali masakrash, Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Në anën njerëzore është një popull i shtypur, kurse nga ana tjetër, është një qeveri raciste që kryen padrejtësi të ndryshme. Të gjitha këto gënjeshtra dhe shpifje e kanë burimin dhe janë të orientuara nga Amerika dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe nga të ashtuquajturit mendimtarë perëndimorë për çështjet e demokracisë.

Në qoftë se e shohim nga pikëpamja e sigurisë, çështja palestineze është një kërcënim jo vetëm për qytetarët e saj, por edhe për gjithë rajonin. Ata kanë një arsenal bërthamor dhe janë ende duke prodhuar shumë armë të tilla. Kombet e Bashkuara kanë paralajmëruar në mënyrë të përsëritur, por atyre nuk u intereson të veprojnë. Arsyeja kryesore që ata nuk dëgjojnë, është mbështetja amerikane. Kjo do të thotë se faji i veprave sioniste dhe shtetit uzurpator bie kryesisht mbi supet e administratës amerikane. Është e njohur që gjatë pesëdhjetë viteve të sundimit hebre, nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dolën 29 vendime kundër Izraelit, por Amerika ushtroi të drejtën e vetos kundër të gjithave. Kanë kaluar gati dhjetë vjet që nga viti 1990, nga propozimi i ish-Bashkimit Sovjetik, në të cilin Amerika nuk lejoi të bëhej Rezoluta e Këshillit të Sigurimit kundër Izraelit.

Prandaj, përgjegjësia për të gjitha këto krime bie mbi Amerikën. Amerika, e cila sponsorizon procesin e paqes, tregon një buzëqeshje dashakeqe dhe helmuese kundrejt të gjithë popujve, përfshirë këtu edhe popullin tonë të dashur dhe të shtypur. Ajo është kriminelja e parë në çështjen e Palestinës. Dora e saj është e zhytur deri në bërryl në gjakun e popullit palestinez”.¹¹

¹¹ Marrë nga libri “El Intifadetu ue muameretu el istikbar”, botim i shoqatës kulturore “El Mearif el Islamijeh eth Thekafijeh”.

ÇFARË FSHIHET PAS ARROGANCËS?

Ekziston një pyetje, të cilës shpesh nuk i kushtojmë vëmendje. Të gjitha këto përpjekje, shtetet e arrogancës globale, a po i kryejnë për të dominuar botën? Apo ndodhet dikush pas tyre, që i shtyn dhe i nxit ato drejt kësaj sjellje arrogante?

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) i përgjigjet kësaj pyetjeje: “Shejtani i arrogancës është kujdesur ta përhapë frontin e tij në të gjitha vendet e botës. Ai i ka ndërlidhur të gjitha çështjet e jetës njerëzore dhe i ka prekur të gjitha grupet njerëzore në shoqëri. Me frontin e shejtanit, kam për qëllim materializmin perëndimor, që planifikon prijësit e të keqes dhe të arrogancës, e cila bazohet në interesat e pronarëve të kompanive të mëdha, te kapitali i madh, te tirania e tyre dhe te pangopësia e tyre”.¹²

Kjo tregohet qartë në fjalët e ish-sekretares amerikane të Shtetit, Madelen Ollbrajt, e cila e portretizon më së miri të vërtetën e kësaj lakmie materiale. Në një nga fjalimet e saj, ajo thotë: “Qëllimi kryesor i qeverisë sonë është të miratojë

¹² Ramazan viti 1417 Hixhri, në Universitetin e Teheranit.

se përfitimet e ekonomisë së Shteteve të Bashkuara do të shtrihen në nivelin global”.¹³

Nisur nga këtu, ne dallojmë dhe shohim qëllimet ekonomike që kërkon të arrijë arroganca me pushtimet e saj në vende të tilla, si Iraku, i pasur me naftë. Kontratat ekonomike, të deklaruara nga kompanitë amerikane, arritën në rreth shtatë miliardë dollarë. E gjithë kjo ndodhi, pasi u anuluan kontratat e mëhershme”.¹⁴

¹³ “Sina’atul karar fil Emrija”, botim i shoqatës kulturore “El Mearif el Islamijeh eth Thekafijeh”, f. 183, nga ligjërata e Dr. Muhamed Selim Uehbetu.

¹⁴ “Sina’atul karar fil Emrija”, botim i shoqatës kulturore “El Mearif el Islamijeh eth Thekafijeh”, f. 193, marrë nga gazeta “El Sefijr”, Nr. 9251.

PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJES

“Kultura amerikane bie në kundërshtim me të gjitha shprehjet e demokracisë. Ajo synon të krijojë një bashkësi gjithëpërfshirëse konsumatorësh. Nëpërmjet saj, ajo kërkon të fshijë dhe të zhdukë standardet familjare, shtetësinë, madje kërkon të zhdukë edhe vlerat morale njerëzore (humanizmin njerëzor). Në këtë mënyrë, mbetet vetëm konsumatori. Politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është e lidhur me fuqinë e saj dominuese e sunduese”.¹⁵

¹⁵ “Sina’tul karar fil Emrijka”, botim i shoqatës kulturore “El Mearif el Islamiyeh eth Thekafiyeh”, f. 196, nga ligjërata e Dr. Muhamed Selim Uehbetu.

QËLLIMET E ARROGANCËS GLOBALE

Nga sa kemi paraqitur më sipër, dalin në dukje objektivat më të rëndësishme që kërkon të realizojë arroganca globale, me përpjekjen e saj për të sunduar botën. Ajo bazohet në tri pika kryesore, të cilat janë: ekonomike, politike dhe kulturore. Nisur nga ky shkak, Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Një prej parakushteve të frymës arrogante – është me vend dhe i përshtatshëm përdorimi i fjalës arrogancë - në botën tonë bashkëkohore, është mbizotërimi i arrogancës në shumë fusha.

Në thelb, baza e tyre përmbledhet në tri pika: ekonomia, politika dhe kultura. Lëvizja fillon nga maja. Ajo zbret në luginë si një rrymë gjithëpërfshirëse. Ky përrua që ka zbritur, nuk është produkt i këtij viti, ose i vitit para tij. Qëllimi i tij është që ai të rritet, duke iu përshtatur kushteve globale”.¹⁶

¹⁶ Me rastin e themelimit të Mexhlis Shura El Islamij (Kuvendi i konsultës islame), 15 Rebiul Erue, viti 1423 Hixhri, Teheran.

MJETET E ARROGANCËS PËR TË KONTROLLUAR DHE PËR TË SUNDUAR BOTËN

- Prezantim
- Sundimi politik
- Mashtrimi politik i fuqive arrogante
- Presionet e jashtme të arrogancës
- Sundimi ekonomik
- Privimi i shteteve nga vetëmjaftueshmëria
- Shoqëria konsumatore është ëndrra dhe dëshira e arrogancës
- Hegjemonia kulturore:
 - a. Demoralizimi
 - b. Përhapja propagandistike brenda umetit
 - c. Promovimi dhe përhapja e parullave të rreme
 - d. Përpjekje për të shthurur brezin e ri

PREZANTIM

Në këtë kapitull do të flasim mbi metodat që përdorin dhe ndjekin vendet arrogante për të kontrolluar vendet e varfra dhe ato në zhvillim nga ana politike, kulturore dhe ekonomike. Shembujt më të qartë që mund të përmendim këto ditë, janë Palestina dhe Iraku. Janë të natyrshme shembujt që sjell Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në këtë kontekst. Të dyja këto ngjarje kanë qenë ndër çështjet më të rrezikshme që kanë kryer fuqitë e arrogancës globale.

SUNDIMI POLITIK

Nuk është e domosdoshme që fuqitë arrogante ta pushtojnë një vend, për të vendosur pushtetin e tyre politik dhe të arrijnë qëllimet e tyre. Para nesh janë shumë shembuj nga bota islame, ku Perëndimi zbaton vendimet e tij politike në shumë prej këtyre vendeve, edhe pse tanket e tij kurrë nuk e vunë këmbën në tokën e tyre për t'i pushtuar.

Nisur nga ky fakt, shkëlqesia e tij, Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*), tërheq vëmendjen lidhur me këtë hegjemoni të arrogancës.

Ai thotë: “Sot ne po qëndrojmë përsëri para një prej momenteve fatale dhe vëzhgojmë një nga ato provimet gjithëpërfshirëse... Amerika synon, që pas përfundimit të së ashtuquajturës Luftë e Ftohtë, falë heshtjes së frikshme që sundon mbi disa nga vendet e këtij rajoni, si dhe bazuar në praninë ushtarake në Gjirin Persik, të zgjidhë problemin e saj dhe problemin e sionistëve pushtues, në mënyrë që arabët të njohin Izraelin dhe Palestina të shuhet përgjithmonë”.¹⁷

¹⁷ Marrë nga libri “El Intifadetu ue muamere el istikbar”, botim i shoqatës kulturore “El Mearif el Islamijeh eth Thekafijeh”.

Nga qëllimet më të rëndësishme të arrogancës globale dhe veçanërisht Shteteve të Bashkuara në këtë rajon, është zhdukja e Palestinës, si dhe përjetësimi i ekzistencës së shtetit izraelit, në zemrën e botës islame.

Shkëlqesia e tij, Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*), thotë: “Armiku synon dhe ka për qëllim ta ndajë dhe ta presë Palestinën një herë e përgjithmonë nga trupi i botës islame. Ai ka për qëllim të mbajë pemën e mallkuar të Sionizmit në trojet e myslimanëve. Amerika synon që, duke instaluar regjimin pushtues, të sundojë në të gjitha venat e jetës në këtë rajon të ndjeshëm, si dhe të shpëtojë vetveten nga Zgjimi Islam në Lindjen e Mesme dhe Afrikë. Armiqtë e Islamit, në këtë mënyrë, dëshirojnë të shfryjnë tërë urrejtjen e tyre të fshehur ndaj Islamit dhe të marrin hak për të gjitha disfatat që kanë pësuar vitet e fundit, si rezultat i zgjimit të myslimanëve.

Kjo ngjarje nuk mund të krahasohet me asnjë nga konspiracionet e bëra kundër Lindjes së Mesme në vitet e fundit. Debati këtu ka të bëjë me dhunimin e një kombi të tërë, me zhvendosjen e vazhdueshme dhe të përhershme të një populli të tërë. Zhvatjen e një pjese të trupit të botës islame dhe qendrës gjeografike të atdheut të madh islam, si dhe Kiblës së parë të myslimanëve, duke e zhdukur përfundimisht atë”.¹⁸

¹⁸ Burimi i mëparshëm.

MASHTRIMI POLITIK I FUQIVE ARROGANTE

Fuqitë arrogante ndjekin forma politike dinake e mashtruese. Kjo është një praktikë e njohur historike. Ata nuk pengohen nga vlerat morale, as nga ndjenjat njerëzore, sepse janë distancuar në ambicien e tyre të paligjshme. Nisur nga ky fakt, del në pah që kujdesi është gjithmonë një detyrë. Çdo propozim që vjen nga këto forca, është e domosdoshme të merret me hezitim dhe nën masa sigurie. Veçanërisht, kur ne e dimë se ai nuk do t'i përmbahet adoptimit të një metodologjie, por do të bëjë ç'është e mundur për të përmbushur qëllimet e tij, duke përdorur metodat më shkatërruese dhe të paligjshme larg standardeve njerëzore, morale dhe fetare.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) na tërheq vëmendjen, lidhur me këtë të vërtetë. Ai thotë se armiku është një politikan. Është me përvojë në politikë, si dhe zotëron një mendje të shkëlqyer politike. Ai e mendon mirë atë që duhet të bëjë. Ndër planet e tij është se ai nuk i zbulon fjalët e tij të fundit në fillim. I shfaq qëllimet e tij ngadalë. E detyron kundërshtarin e tij të tërhiqet. Sapo kundërshtari tërhiqet, ai shfaq një tjetër kërkesë. Disa mendojnë. I japim diçka dhe ne marrim në këmbim diçka

prej tij. Është e vërtetë se ne japim, por për të marrë prej tij nuk është një mundësi, sepse nuk do të japë asgjë. Ata po trillojnë parulla. E kanë vendosur Iranin si pjesë të boshtit të së keqes. Na kërkojnë të veprojmë kështu e ashtu, për të na larguar (fshirë) nga boshti i së keqes. Ata ndërmorën një çmenduri, kur na përfshinë në boshtin e së keqes.

A duan ata të na fshijnë? Apo do të na kthejnë përsëri, sapo ta kenë të nevojshme të na përfshijnë në boshtin e së keqes? Kështu që duhet të tregoni kujdes, sepse kjo tërheqje nuk ka kufij. Nëse tërhiqeni nga kjo llogore, ata do të nxjerrin një tjetër kërkesë, sikurse është kërkesa, që ta pranojmë këtë qeveri të paligjshme. Do t'i ripërsërisin të njëjtat presione dhe kërcënime. Sapo të pranohet një kërkesë, ata bëjnë një tjetër, si: largoni (fshijeni) emrin “islam” nga kushtetuta. Duhet të largoheni dalëngadalë prej Islamit. Këto kërkesa nuk njohin kufij”.¹⁹

¹⁹Me rastin e takimit të udhëheqësit të Revolucionit Islamik, me anëtarët e Komitetit të Këshillimit Islam, më 26 Rebiul Euel, viti 1424 Hixhri, Teheran.

PRESIONET E JASHTME TË ARROGANCËS

Arroganca dhe fuqitë që pretendojnë se janë të mëdha, ndjekin metodën sa të vjetër, aq edhe të re, duke u bërë presion kombeve që nuk i nënshtrohen vullnetit të tyre politik. Arroganca ka ndërmarrë edhe shumë hapa në këtë drejtim.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka treguar për presionet e ushtruara nga këto shtete. Zyrtarët e lartë duhet të dinë mbi realitetin e këtyre presioneve dhe mënyrën e përbaljes me to.

Ai ka thënë: “Unë e kam ngritur dhe e kam trajtuar këtë çështje në mënyrë të përsëritur me disa zyrtarë që vuanin nga vesveset dhe frika. U thashë atyre të më tregojnë se deri në çfarë mase arrijnë kufijtë e presionit amerikan.

M’i tregoni, se nëse i plotësojmë, ata do të mjaftohen dhe nuk do të vijojnë të na bëjnë presion më shumë. Ma tregoni dhe shpjegoni se ku fshihet kufiri i tyre. Jua tregoj unë. Ai është aty ku ju e ngrini zërin. Është e drejta që keni ju, jo e imja, që në emër të popullit iranien të deklaroni se ne nuk duam Islamin, Republikën Islamike dhe qeverinë e

popullit. Lejojini amerikanët të vendosin këdo që duan ata në interes të tyre të drejtojnë këtë vend. Ky është kufiri.

Pra, e para, është robërimi i vendit. A mund ta bëni diçka të tillë? A mund ta dorëzojmë unë dhe ti vendin në duart e armikut? A e kemi një të drejtë të tillë? Populli nuk na zgjodhi në krye të çështjeve për këtë arsye.

Në këndvështrimin tim, ekziston një ekzagjerim dhe mbivlerësim i armikut. Mendimi im nuk është për shkak të mungesës së njohurisë sime mbi armikun. Jo, sepse unë i tejkaloj shumë prej jush në njohuritë e mia mbi aftësitë që ata kanë dhe pajisjet që ata prodhojnë, por edhe ne e dimë se çfarë po ndodh në botë.

Armët, spiunazhi dhe pajisjet e inteligjencës etj., nuk janë të mjaftueshme për të imponuar sundimin e tyre mbi një popull të vendosur dhe liridashës. Ky është shkaku që i shihni ata duke deklaruar: “Me Iranin duhet të punojmë e të veprojmë nga brenda. Duhet të dobësojmë vullnetin e tij liridashës. Nëse vullneti i popullit nuk dobësohet dhe nuk nënshtrohet, ai mishërohet në vullnetin e zyrtarëve të zgjedhur nga populli, atëherë nuk mund të bëjnë asgjë.

Armiqtë do të bëjnë presion. Do të përballemi me shumë vështirësi. Ne duhet të durojmë në rrugën e pavarësisë, të ruajtjes së identitetit kombëtar dhe shmangien e turpërimit para historisë.

Imagjinoni, nëse Shah Sulltan Husejn Es Safauij do të kishte menduar me veten e tij e do të thoshtë: “Nëse mendoj për vete, unë kam vetëm një shpirt dhe kam jetuar tërë këtë jetë. Sa vjet do të jetoj në të? Por, nëse do të mendoj për njerëzit, fatkeqësia që do t’i godasë ata, në rast se u dorëzoj pushtuesve Esfehanin, nuk është më pak e vogël se fatkeqësia nga përballja me pushtuesit”.

Nëse do të mendonte kështu, ai kurrë nuk do ta dorëzonte qytetin.

Lexoni historinë e Esfehanit dhe shikoni se çfarë fatkeqësie dhe shkatërrimi kryen pushtuesit, pasi hynë në Esfehan, Kashan dhe në rajonet e zonave në qendër të Iranit, Persisë dhe rajoneve të tjera. Çfarë masakrash kryen ata kundër njerëzve, pasi u dorëzuan. Pushtuesit nuk thanë, se meqenëse u dorëzuat, shpërblimi juaj është që të jetoni të gjithë të sigurt. Historia përsëritet edhe sot, shikoni se çfarë i bëjnë ata popullit irakian. Këto janë veprimet dhe sjelljet e tyre, kudo që ata vendosin kontrollin dhe sundimin e tyre.

Sprova dhe fatkeqësia që është e destinuar të godasë personin, nuk duhet të përfshijë njerëzit, veçanërisht, kur është si rezultat i dorëzimit, sepse është më e rëndë dhe shoqërohet me poshtërim. Sprova dhe fatkeqësia që vjen pas rezistencës, më e pakta, është se vlerësohet dhe nuk

shoqërohet me poshtërim, por ajo është sakrifica, lufta dhe vdekja në fushën e betejës.

Unë këmbëngul fuqishëm, bazuar në vendosmërinë dhe në qëndrueshmërinë që zotëron populli, se Esfehani nuk ra në duart e pushtuesve, edhe pse kishte shumë udhëheqës dhe zyrtarë të dobët e tradhtarë, por populli ishte i gatshëm, vetëm se ata duhet të bashkoheshin me njerëzit e zakonshëm dhe të luftonin.

Kjo është një çështje që i përket historisë, por përgjegjësia bie mbi shpatullat e zyrtarëve të qeverisë dhe të shtetit, pavarësisht, nëse ato përfshijnë organet legjislative, gjyqësore apo ekzekutive, pasi të gjithë janë pjesë e këtij sistemi”.²⁰

²⁰ Me rastin e takimit të udhëheqësit të Revolucionit Islamik, me anëtarët e Komitetit të Këshillimit Islam, më 26 Rebiul Euel 1424 Hixhri, Teheran.

SUNDIMI EKONOMIK

Nuk ka asnjë dyshim se vendet arrogante kanë qëllime ekonomike dhe kërkojnë t'i imponojnë ato qëllime.

Ata synojnë dominimin e ekonomisë botërore, për të plaçkitur pasurinë e popujve të pafuqishëm e të pambrojtur. Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) e tregon këtë fakt dhe i paralajmëron myslimanët për këtë, duke u thënë: “Arroganca, qoftë në Iran apo në pjesën tjetër të vendeve islame, kërkon të ketë njerëz robër, të poshtëruar, të nënshtruar dhe të bindur, që nuk kanë interes të jetojnë me krenarinë e tyre dhe të ruajnë trashëgiminë kulturore. Ata duan njerëz që nuk tregojnë asnjë interes kundrejt plaçkitjes së pasurisë së tyre morale dhe materiale”.²¹

²¹ Me rastin e hytbes së namazit të Bajramit, 1 Sheval, viti 1423 Hixhri, Teheran.

PRIVIMI I SHTETEVE NGA VETËMJAFTUESHMËRIA

Arroganca përpiket, me të gjitha mundësitë e saj dhe në çdo kohë, që të mos lejojë asnjë vend të arrijë fazën e vetëmjaftueshmërisë, në fushat e vetëplotësimit të nevojave ushqimore, ilaçeve dhe industrisë bazë. Vetëplotësimi i nevojave mund t'i çlirojë këto vende nga prangat e shantazheve. Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) na tregon mbi përvojën që kaluan iranianët në fazën e parë të fitores së Revolucionit Islamik. Në atë periudhë ata morën në dorë një vend, ku Shahu ishte thjesht një konsumator i mallrave të huaja.

Midis të tjerash, Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Vendi ynë, që është bërë një shënjestër i synimeve dhe qëllimeve të këqija, të mbushura me urrejtje nga tiranët e botës, për shkak të refuzimit për t’iu nënshtruar arrogancës së tiranëve, sot ka nevojë, më shumë se kurrë, për të siguruar nevojat e tij ushqimore. Në këtë mënyrë, vendi ynë nuk do të ketë nevojën e vendeve të tjera, që të sigurojë prej tyre bukën e nevojshme, ushqimin e

përditshëm, vajrat dhe mishin. Vendi ynë nuk ka nevojë për dikë që mund të bëjë pazar me të për nderin e tij, në këmbim të kësaj dhurate. Sigurimi i ushqimit për popullin tonë është një çështje shumë e rëndësishme.

Kur njoftuan gjatë vitit të kaluar se vendi ynë kishte arritur fazën e vetëmjaftueshmërisë në të korrat e grurit, unë mendoj se ishte një festë e madhe për këtë vend.

Gjatë periudhës së regjimit tiranik, qeveria iraniane importonte grurë nga Amerika. Rusia ndërtonte depo gruri për ta. Ata nuk ishin në gjendje të prodhonin një depo të vetme gruri. Duhet të vinin rusët, ta ndërtonin një gjë të tillë. Shkaku ishte se kjo industri nuk ekzistonte në Iran në atë periudhë.

Erdhën të rinjtë revolucionarë, universitarë, në vitet e para të revolucionit. Çështja është se gruri ka nevojë për depo, pra, si do të veprojmë për këtë? Ne nuk kemi zgjidhje tjetër përveçse të mbështetemi në vendosmërinë dhe forcat tona, kështu që të rinjtë filluan të punojnë në këtë drejtim.

Kompanitë pushtuese sioniste dhe të tjerët duan të plaçkitin dhe të zhvatin pasurinë e botës. Është e vështirë për ta të shohin se ekziston një popull që zhvillohet në të gjitha fushat, si dhe hedh poshtë e nuk i pranon gënjeshttrat e pretendimet e tyre. Përkundër kësaj, populli iranian do të zhvillohet dhe do të shkojë përpara. Islami do të forcohet më shumë se sa është tani. Flamuri i krenarisë islame do të

valëvitet mbi kokat e banorëve të këtij populli dhe te të gjithë popujt e botës islame, me lejen dhe dëshirën e Zotit të Plotfuqishëm”.²²

²² 3 Dhul Hixhxheh, viti 1426 Hixhri.

SHOQËRIA KONSUMATORE ËSHTË ËNDRRA DHE DËSHIRA E ARROGANCËS

Shtetet arrogante janë të lumtura të na shohin ne si një shoqëri që konsumon të mirat e tyre. Shoqëria, e cila duhet të jetë e aftë dhe e pavarur në ekonominë e saj dhe t'i bëjë të pavarur anëtarët e saj, kthehet në një treg të thjeshtë, që gjeneron fitime në interes të shteteve shtypëse. Kur të bëhemi të tillë, të varur prej tyre, këto vende do të na pushtojnë, duke na diktuar atë që duan, në lidhje me vendimet që marrin. Këtë e bëjnë përmes shantazheve dhe kërcënimit të urisë dhe privimit ekonomik.

Në lidhje me seriozitetin e kësaj situatë, Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*), ka thënë: “Një nga gjërat që i pengon ata të ndihmojnë të varfrit dhe të shtrijnë drejt tyre dorën e ndihmës, është përhapja e shpirtit të konsumit dhe e mburrjes në shoqëri. Është kthyer në dukuri prirja e saj drejt konsumit, ditë pas dite. Një mënyrë që të gjithë dëshirojnë të konsumojnë dhe të kënaqen duke ngrënë, duke pirë, duke u veshur dhe duke kërkuar ndjekjen e modës, si dhe të gjithçkaje që është e lidhur me

nevojat dhe luksin e jetës. Shumë pasuri dhe para harxhohen në këtë drejtim. Ato nuk shpenzohen në vendet që çojnë në kënaqësinë e Zotit dhe në trajtimin e problemeve të shtresave të ndryshme të njerëzve.

Prirja drejt konsumit është një fatkeqësi e madhe për shoqërinë. Ekstravaganca i rrit, i shumëfishon dhe i thellon dallimet klasore në shoqëri mes të varfërve dhe të pasurve ditë pas dite. Një nga çështjet që bijtë e këtij populli duhet ta konsiderojnë si detyrën e tyre, është të shmangin ekstravagancën. Organet dhe agjencitë përgjegjëse në institucionet e ndryshme të shtetit, sidomos media dhe aparati kulturor, e në mënyrë të veçantë radioja dhe televizioni, duhet ta shohin dhe ta ndiejnë që është detyra e tyre, që të mos i tërheqin masat popullore vetëm drejt shpenzimeve, ekstravagancës, konsumit dhe në zbukurime.

Përkundrazi, udhëzojini ato në drejtim të kundërt. Ftojini njerëzit dhe drejtojini ata drejt kënaqësisë, mjaftueshmërisë dhe shpenzimeve sipas nevojës, shmangni tepricën dhe ekstravagancën, pasi fryma e konsumit shkatërron shoqërinë.

Në një shoqëri, ku konsumimi tejkalon prodhimin e saj, do të mposhtet. Ne duhet të mësohemi të ekuilibrojmë konsumin tonë dhe ta kufizojmë atë, si dhe të braktisim ekstravagancën. Të rinjtë duhet të organizojnë tubime familjare dhe të mbledhin ndihma për anëtarët e fisit të tyre. Këto kontribute, në radhë të parë, t'i shpenzojnë për

anëtarët më të varfër dhe në nevojë të atyre familjeve. Nëse ata nuk kanë nevojë, le t'i shpenzojnë për pjesën tjetër të të varfërve të shoqërisë.

Shpresojmë që Zoti i botëve të na bekojë dhe të na udhëzojë ne dhe mbarë popujt myslimanë me vigjilencë, si dhe të motivojë zyrtarët e vendeve islame për të kryer detyrat e tyre".²³

²³ Me rastin e hytbes së namazit të Bajramit, 1 Sheval, viti 1423 Hixhri, Teheran.

HEGJEMONIA KULTURORE

Është mëse e sigurt që media është një nga mjetet më të rëndësishme që fuqitë arrogante përpiqen për hegjemoni kulturore mbi kombet e tjera. Dominimi dhe hegjemonia kulturore është një çështje shumë e rrezikshme. Ajo është më strategjike dhe më e thellë se pushtimi politik dhe ushtarak. Ajo ngulitet në mendjen e popullit. Për këtë çështje na paralajmëron Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*). Në këtë kontekst, ai përqendrohet në disa pika, duke përfshirë:

a- Demoralizimi

Kjo realizohet përmes humbjes së vetëbesimit të shoqërisë. E portretizon atë si një shoqëri të paaftë për të ecur me të njëjtin hap me vendet e mëdha, veçanërisht në nivelet shkencore, teknike dhe ekonomike.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Fuqitë arrogante në botë, ne myslimanëve, përmes borive të tyre mediatike, na kanë ftuar të shohim me vëmendje realitetin e botës. Këtë e bëjnë duke na treguar se bota perëndimore është e përparuar dhe e aftë në terma

shkencorë, teknikë, ekonomikë dhe ushtarakë. Prandaj ne nuk kemi zgjidhje tjetër përveç dorëzimit dhe tërheqjes përballë tyre”.²⁴

b – Përhapja propagandistike brenda umetit

Një nga gjërat që nuk duhet të neglizhohet, është ekzistenca e disa njerëzve që janë të veshur me kulturë dhe intelekt. Ata luajnë një rol shkatërrues në destabilizimin e vetëbesimit të umetit në vetvete dhe në aftësitë e tij. Ata kontribuojnë, me dashje ose pa dashje, në skemën që synon të mbizotërojë vendimin politik dhe trashëgiminë kulturore të popujve.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë se ata janë paralajmëruar në Kur'anin Fisnik. Allahu i Madhëruar i përshkruan ata hipokritë dhe thotë: **“Nëse nuk heqin dorë (nga veprimet e tyre) hipokritët, ata që kanë sëmundje (dyshimi) në zemrat e tyre dhe ata që përhapin lajme të gënjeshtërtë në Medinë, Ne me siguri, ty do të të japim pushtet mbi ta dhe ditët e tyre në Medinë do të jenë të numëruara.**

²⁴ Me rastin e takimit të udhëheqësit të Revolucionit Islamik, me anëtarët e Komitetit të Këshillimit Islam, më 26 Rebiul Euuel, viti 1424 Hixhri, Teheran.

Ata janë të mallkuar kudo që të gjenden dhe do të kapen e do të vriten pa mëshirë.”.²⁵

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Rrymat politike kanë përqendruar përpjekjet e tyre kundër Republikës Islamike të Iranit dhe Rilindjes së madhe islame të popullit iranian dhe popujve të tjerë të rajonit. Ata janë përqendruar në nxitjen e trazirave dhe mbjelljes së frikës në zemrat e tyre. Kjo është politika e përgjithshme e perandorisë mediatike sot. Sigurisht që kjo nuk është diçka e re për ne. Ajo ka vazhduar përgjatë njëzet viteve të fundit, që ne ndodhemi në rrugën e së vërtetës, sikurse është përpjekur gjatë gjithë historisë, që nga fillimi i Islamit e deri në ditët e sotme.

Prandaj, do të vërejmë se në një nga temat ku është përqendruar Kur’ani Fisnik, duke e konsideruar si një cilësi negative, është tema e hipokrizisë. Hipokritët janë ata që përpiqen të mbjellin frikë në zemra dhe t’i shpërqendrojnë ato. Para disa ditësh, këtë ajet fisnik unë ua lexova disa të dashurve të mi që ishin të pranishëm këtu: “(Shpërblim kanë edhe ata) **të cilëve njerëzit (hipokritë) u thanë: ‘Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!’**”²⁶

Ata frikësonin dhe provokonin banorët në qytetin e Profetit, duke u thënë se njerëzit janë mbledhur dhe duan

²⁵ Sure “El Ahzâb”, ajetet 60-61.

²⁶ Sure “Ali Imran”, ajeti 173.

t'ju shkatërrojnë dhe kërkojnë asgjësimin tuaj, por gjithçka mbaroi. Allahu i Madhëruar zbriti ajetin fisnik: **“Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”**

Ky ajet zbriti për të treguar se, kur nxitet konfuzioni, thashethemet dhe pesimizmi, atëherë në këtë atmosferë të ndotur nga përhapja e virusit të frikës dhe tmerrit, besimtarëve u shtohet besimi dhe thonë: **“Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”**

Ky është argumenti që duam të tregojmë. Besimtarët janë të qetë në rrugën e tyre. Edhe pse armiqtë e tyre përpiqen nëpërmjet rrugës së luftës informative dhe psikologjike t'i trembin dhe t'i shpërqendrojnë, besimtarët janë të pushtuar nga “qetësia” që Zoti ka vendosur në zemrat e tyre.

Allahu i Madhëruar është Ai është që ka vendosur qetësi në zemrat e besimtarëve, në mënyrë që besimi i tyre të rritet, që ata të forcohen në besim me besimin e tyre. Kjo është e vërteta e çështjes.

Duhet thënë se në kushtet e terrorit, të frikës, të trazirave dhe ankthit, besimi fshihet nga kujtesa e njeriut. Kjo është gjendja e një personi të frikësuar. Frika e prish mendjen, e lëkund vendosmërinë për punë. Një njeri i frikësuar nuk është i aftë të arsyetojë drejt. Ai nuk e ka aftësinë për të vepruar me vendosmëri dhe vullnet. Asnjëherë ai nuk e bën një hap përpara vetëm se tërhiqet një

hap prapa. Nga këtu buron edhe porosia e njohur e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), për Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*): “Mos u këshillo me një frikacak, sepse ka për të ta vështirësuar zgjidhjen”.

Një njeri që nuk ka frikë, është i aftë të mendojë drejt dhe të marrë vendimin e duhur. Ai i tejkalon vështirësitë. Në rast se është i frikësuar, atëherë do ta vështirësojë zgjidhjen. Ai heziton, nëse duhet të veprojë apo jo dhe do të dorëzohet pa vepruar asgjë. Për këtë arsye, qetësia është jashtëzakonisht e rëndësishme në marrjen e vendimeve”.²⁷

c- Promovimi dhe përhapja e parullave të rreme

Promovimi dhe përhapja e parullave të rreme janë nga gjërat më të rëndësishme të përhapura nga mediat hegjemoniste mbi umetin islam, nëpërmjet rrugëve propagandistike perëndimore dhe të mbështetur nga disa stilolapsa (shkrimtarë) të paguar. Ata përfitojnë prej kësaj propagande që është në interesin e tyre dhe veprojnë si u pëlqen. Fakti është se ata janë ndër shkelësit më të rëndë të

²⁷ Me rastin e takimit të udhëheqësit të Revolucionit Islamik, me anëtarët e Komitetit të Këshillimit Islam, më 26 Rebiul Euuel, viti 1424 Hixhri, Teheran.

të drejtave. Po përmendim si shembull demokracinë, lirinë dhe të drejtat e njeriut.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Ata e shqiptojnë demokracinë si një parullë. Ata e dinë që gjithë popujt e botës janë të vetëdijshëm për këtë. Politika e propagandës në botë përqendrohet në të folurit, të folurit dhe vetëm të folurit, pra, te përsëritja.

Pra, kjo është media dhe politika propagandistike në botë. Ata flasin e flasin dhe përsërisin ato që flasin. Rezultati është se e gjithë kjo do të ndikojë në një grup njerëzish, ose më e pakta është se vetë njerëzit mësohen të dëgjojnë.

Në të kundërt, ata nuk mund t’i qeverisin njerëzit. Janë shumë regjime që udhëheqin, por ato nuk e mësojnë kurrë se çfarë mendon populli i tyre për ta. Popujt e tyre asnjëherë nuk e dinë se çfarë do të thotë të votosh dhe të zgjedhësh zyrtarët e vendit të tij. Pa i kundërshtuar askush, ata akuzojnë Republikën Islamike, pavarësisht organizimit të zgjedhjeve dhe pjesëmarrjes së publikut në të gjitha sferat, si dhe pavarësisht nga gjitha modelet dhe shembujt e qeverisjes së popullit që mbizotërojnë në vend. Një model i tillë qeverisjeje, rrallë mund të gjendet në një vend tjetër në botë. Është e veçantë marrëdhënia e zyrtarëve me masat, familjariteti i tyre me ta, mbështetja e masave për zyrtarët e tyre, emocionet dhe dashurinë që ata ndiejnë për zyrtarët e lartë. E gjithë kjo vjen se populli e ndien që është

palë në udhëheqje. Ata nuk janë të sunduar nga tirania dhe diktatura. Populli e ka të qartë se çfarë ndodh e çfarë duan.

Çështja nuk ka të bëjë me demokracinë dhe as me armët e shkatërrimit në masë. Në të vërtetë, janë ata që e mbushën rajonin me armë. Le të hedhim një vështrim mbi shtetin sionist. Ai është përfaqësuesi më domethënës i një rasti të tillë. E njëjta gjendje është edhe në rajone të tjera. Ishin ata që i ofruan ndihmë regjimit të Sadamit për të prodhuar raketa me një distancë prej një mijë apo një mijë e pesëqind kilometra. Gjithashtu, i ofruan pajisje për lëndët kimike, si dhe e ndihmuan atë t'i prodhojë ato, ndërkohë që tirania sundonte Irakun".²⁸

d- Përpjekje për të shthurur brezin e ri

Ndër metodat që përdor arroganca, është edhe metoda e pushtimit kulturor te brezi të ri. Brezi i ri përfaqëson pasurinë më të madhe të çdo shoqërie. Tek ai varet reformimi dhe ecuria e shoqërisë.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) na tregon përpjekjet e arrogancës për të pushtuar mendjet e rinisë: "Armiqtë e kanë kuptuar se ky popull është bashkuar

²⁸ Fjala e udhëheqësit të revolucionit me rastin e takimit të udhëheqësit të Revolucionit Islamik, me anëtarët e Komitetit të Këshillimit Islam, 26 Reuiel Euuel, viti 1424 Hixhri, Teheran.

me mirësinë e besimit (imanit). Ky popull ka zgjedhur një udhëheqës që nuk u frikësohet aspak fuqive të mëdha me mirësinë e besimit. Kundërshtarët tanë janë në gjendje armiqësie me besimin tonë, me fenë tonë dhe Islamin. Ata përdorin mjete propagandistike dhe politike dhe na stigmatizojnë, duke na përshkruar me cilësi që ata mendojnë se na ofendojnë. Përkundrazi, ne krenohemi me to dhe i konsiderojmë pjesë të lavdisë sonë. Ne jemi krenarë për kthimin tonë në origjinën tonë islame. Pikërisht këtu fshihet dhe qëndron sekreti i forcës sonë.

Në vitet e fundit, propaganda e arrogancës globale është përqendruar në minimin dhe prishjen e besimit tonë islam. Populli ynë nuk do të bëjë njërin sy qorr kundrejt atyre që na fyejnë dhe dhunojnë për shkak të përkatësisë sonë të besimit në fenë islame. Islami është gjithçka për popullin tonë. Feja islame dhe besimi ynë monoteist janë themelet e krenarisë dhe fitores sonë. Besimi është ai që rregullon dynjanë dhe Ahiretin tonë”.²⁹

²⁹ Fjala e udhëheqësit të revolucionit në ceremoninë e besëlidhjes popullore në qytete të ndryshme iraniane së bashku me Shkëlqesinë e tij.

PËRBALLJA ME ARROGANCËN

- Prezantim
- Parullat dhe përballja me arrogancën
- Përballja me arrogancën është e natyrshme
- Si të përballemi me arrogancën?
 - a - Uniteti dhe bashkimi
 - b - Të jemi të guximshëm
 - c - Vigjilenca dhe kujdesi
 - d - Ruajtja e angazhimit fetar

PREZANTIM

Ne u njohëm me rrezikun e arrogancës kundrejt kombeve. Mësuam qëllimet që kërkon të realizojë nëpërmjet dominimit të fuqisë së saj. Gjithashtu, u njohëm me metodat e ndyra që ajo përdor për të arritur këto qëllime. Le të rikthehemi e të flasim për mënyrën se si të përballemi me këtë armik që qëndron në pritje për ne. Le të freskohemi te burimi i pastër i kujdestarit të myslimanëve, Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*).

PARULLAT DHE PËRBALLJA ME ARROGANCËN

Disa mund të pyesin pse parullat? Cili është qëllimi i ngritjes së parullave përballë arrogancës? Parulla të tilla, si: “Vdekje për Amerikën!” apo “Vdekje për Izraelin!”, a mund të zgjidhin problemin dhe t’i japin fund ambicieve të tyre historike për të sunduar vendin tonë dhe për të shfrytëzuar pasuritë tona?

A është e mundur që të rezistojë diga e pathyeshme përballë përroit pushtues shumëfytyrësh? Kësaj pyetjeje i përgjigjet Shkëlqesia e tij, Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*): “Parullat që ngrihen në çdo vend dhe në çdo sistem, janë të një rëndësie të madhe. Marrëdhënia me parullat e ndryshme, në çdo vend, trajtohet me ndjeshmëri të veçantë. Në rast se populli, ose zyrtarët nuk dinë mënyrën si t’i trajtojnë parullat, atëherë ata do të përballen me dëme shumë të mëdha.

Është e natyrshme të dëgjojmë disa njerëz të thonë se sot nuk është dita për parulla, por është dita për punë. Kjo shprehje nuk është e saktë, edhe nëse ata që e shprehin atë, kanë qëllimin e sinqertë. Supozimet e tyre janë të vërteta, se vendi nuk mund të menaxhohet vetëm me parulla. As

mund ta ndërtosh vendin vetëm me parulla dhe as nuk mund t'i zgjidhësh çështjet me parulla. Është e domosdoshme që parullat të shoqërohen me punë. Disa i interpretojnë këto mendime në një mënyrë tjetër, sipas asaj që atyre u leverdis. Të tjerë i interpretojnë ato sikur kanë për qëllim t'i sugjerojnë popullit që t'i braktisin parullat. Ky është një gabim, sepse një parullë është si një flamur udhëzues dhe drejtues. Puna pa parullë është si parulla pa punë.

Në mënyrë që populli të njohë rrugën e tij, ajo që duhet të bëjë, është se duhet të ruajë parullat e tij të singerta dhe të qarta. Nëse humbasin parullat, gjendja e popullit bëhet si një grup njerëzish që ecin në shkretëtirë, pa ndonjë udhërrëfyes. Karakteristikë dalluese e parullave është se ajo nuk lejon që një popull, ose një vend të ndjekë një rrugë të gabuar. Atëherë le të jetë kjo një parullë: "Parullë dhe punë, parulla përkrah punës dhe puna në hijen e parullës!"³⁰

³⁰ Me rastin e ditës kombëtare (13 Aban) për t'u përballur me arrogancën botërore, më 17 Xhumada Thanijeti, viti 1417 Hixhri, Teheran.

PËRBALLJA ME ARROGANCËN ËSHTË E NATYRSHME

Disa njerëz të thjeshtë mendojnë se popujt islamë krijojnë armiqësi me shtetet arrogante, si Amerika dhe tjerët. Ky është një mendim shumë naiv. Armiqësia me vendet e arrogancës lindi nga armiqësia e tyre ndaj nesh, nga përpjekja e tyre për të shkatërruar gjithçka që ka të bëjë me kulturën tonë, si dhe nga përpjekjet e tyre të pareshtura për të grabitur dhe për të vjedhur pasuritë tona ekonomike.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*), për këta njerëz të thjeshtë, thotë: “Disa njerëz të zakonshëm na pyesin se pse ne jemi në këtë gjendje me Amerikën dhe për sa kohë do të vazhdojmë etj. Ata nuk e kuptojnë se çfarë po ndodh në botë. Nuk e kuptojnë se çfarë mund të bëjë ky armik arrogant, injorant, irracional, që lakmon më shumë sesa është e drejta e tij. Ata imagjinojnë se problemet tona do të përfundojnë, sapo të fillojnë negociatat me Amerikën. Jo kurrë, çështja nuk është kështu. Po, është e vërtetë se udhëheqësit amerikanë zyrtarisht deklarojnë dhe shprehin gatishmërinë e tyre për të negociuar me Iranin. Por, pse të negociojnë? Dihet se ata, përmes negociatave dëshirojnë të gjejnë mënyra për të ushtruar presion mbi shtetin islam. Ata

duan negociata për këtë çështje. Ne nuk kemi asnjë lidhje me ju. Nuk kemi nevojë për ju. Nuk kemi frikë nga ju. Nuk jemi aspak të interesuar për ju.

Jeni ju që rrëzuat aeroplanin tonë civil në mes të ditës dhe para syve të gjithë botës nën një pretekst të rremë dhe absurd. Vratë dhjetëra njerëz të pafajshëm dhe kurrë nuk e morët përgjegjësinë për të kërkuar falje.

Çfarë sistemi është ky? Çfarë kulture është kjo? Si mund të dëshirojë njeriu një sistem të tillë? Prandaj, mes nesh dhe amerikanëve nuk ekziston marrëdhënia më e vogël e dashurisë, miqësisë dhe afrimitetit. Përkundrazi, ndërmjet nesh është një marrëdhënie urrejtjeje dhe neverie nga ana jonë dhe një marrëdhënie armiqësie dhe dashakeqësie nga ana e tyre".³¹

³¹ Me rastin e ditës kombëtare për t'u përballur me arrogancën botërore, më 27 Xhumada El Ulaa, viti 1415 Hixhri, Teheran.

SI TË PËRBALLEMI ME ARROGANCËN?

Pika kryesore qëndron në njohjen e çështjeve me të cilat ne përballemi me këtë arrogancë. Në vijim ne do t'i referohemi disa prej këtyre pikave, të cilat i ka theksuar Shkëlqesia e tij, Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*), nëpërmjet udhëzimeve të tij të vazhdueshme për bijtë e kombit islam.

a- Uniteti dhe bashkimi

Është e natyrshme që kalaja të mbrohet nga brenda dhe të mos lejojmë hyrjen e atyre që përpiqen të futen në të. Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Ruani unitetin dhe shtrëngoni radhët. Përmendni kujtimin e udhëheqësit dhe burrave të parë të revolucionit. Gjithashtu, sillni ndërmend kujtimin e dëshmorëve të mëdhenj, si dhe kujtimet entuziaste të revolucionit dhe luftës së imponuar në rrethinat e mjediseve të universiteteve, në vendet e punës dhe në jetën publike. Nëse veprojmë në këtë mënyrë, atëherë, me ndihmën e Allahut të Madhëruar, në dekadat e ardhshme, do të mundësohet ndërtimi i një qytetërimi madhështor në Iran dhe në shumë vende të tjera. Islami dhe myslimanët do të kenë madhështi,

status dhe forcë, përpara të cilave nuk do të mundet të qëndrojë arroganca, përkundrazi edhe kolonializmi nuk do të ekzistojë”.³²

b- Të jemi të guximshëm

Nëse ne ndihemi të humbur, para se të fillojë beteja, ose kemi turp të refuzojmë kërkesat e kërkuara nga arroganca, atëherë ne do të jemi thjesht mjete që i shërbejnë interesave të saj. Historia do të na kujtojë si të mallkuar. Këtu buron rëndësia e guximit në thënien e fjalës “JO” me zë të lartë, në mënyrë që armiku të kuptojë se ne jemi prej atyre që nuk tundohemi nga ofertat dhe nuk i lemë çështjet në mes pa zgjidhje.

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) ka thënë: “Armiqtë po na bëjnë presion shumë të madh që përballohet me vështirësi, por ne durojmë, pasi kemi qëllim ruajtjen e pavarësisë sonë, ruajtjen e identitetit tonë kombëtar dhe shmangien e turpit para historisë.

Përgjegjësia jonë, e imja dhe e juaja, sot është jashtëzakonisht e madhe. Duhet ta hapim rrugën me mendje dhe me kujdes, si dhe duke u mbështetur te Zoti dhe duke qenë të guximshëm e jo frikacakë. Objektivi ynë i parë është

³² Me rastin e ditës kombëtare për t’u përballur me arrogancën botërore, më 27 Xhumada El-ula 1415 Hixhri, Teheran.

bashkimi i brendshëm. Prandaj, mos lejoni që këto debate të kthehen në konfrontime, konflikte dhe grindje. Kjo është porosia ime e vetme për ju”.³³

c- Vigjilenca dhe kujdesi

Armiku mund të arrijë objektivat e tij, vetëm nëse na kap në befasi. Në këtë kontekst, do të gjejmë udhëzimet e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*): “Vigjilenca dhe kujdesi janë faktorët më të rëndësishëm që çojnë në prishjen dhe dështimin e planeve të armikut.

Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thotë: ‘*Kush fle vetë, të tjerët nuk flenë për të*’. Kjo do të thotë se ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe vigjilentë kundër kompleteve të përgatitura nga armiku.”³⁴

d- Ruajtja e angazhimit fetar

Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) e ka shprehur në një frazë të shkurtër, por që përfshin një dimensionin të madh shpirtëror: “Nëse ne e ndjekim

³³ Me rastin e takimit të udhëheqësit të Revolucionit islamik me anëtarët e Këshillit të Konsultës Islame, 26 Rabiul Euuel, viti 1424 Hixhri.

³⁴ Me rastin e festës së Ditës së ushtrisë, më 2 Dhil Kaidetu, viti 1414 Hixhri, Teheran.

Rrugën e Drejtë të Zotit dhe i përmbahemi rrugës së devotshmërisë, atëherë furnizimet e fshehta hyjnore do të vijnë te ne, një pas një, në çdo moment, sepse Allahu i Madhëruar i do robtë e Tij të drejtë e të devotshëm dhe i ndihmon ata të përmbushin detyrimet e tyre”.³⁵

³⁵ Me rastin e festës së Ditës së ushtrisë, më 2 Dhi El-kadetu 1414 Hixhri, Teheran.

PËRFUNDIM

Beteja me arrogancën nuk është betejë e një dite apo e një periudhe të caktuar, por përkundrazi, është ecuria e dynjasë që ishte dhe do të mbetet, derisa të shfaqet sunduesi i epokës dhe i kohës. Lusim Allahun e Madhëruar ta shpejtojë ardhjen e tij fisnike dhe ta zgjidhë betejën në favor të besimit, dhe të trashëgojë tokën, ai dhe ata që janë të devotshëm me të.

Në fund, ne i përfundojmë fjalët tona me atë që Shkëlqesia e tij, Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*), përfundoi një nga ligjëratat e tij: “Ne e lusim Zotin të na përfshijë në mirësinë e lutjes së zotërisë dhe të prijësit tonë, El Huxhetu ibn El Hasan El Mehdi (*Allahu i Madhëruar e shpejtoftë daljen e tij!*).

I lutem Allahut të rrisë përparimin e këtij populli ditë pas dite, ashtu sikurse i lutem të lartësojë pozitën e prijësit tonë të madh, i cili e hapi këtë rrugë të ndritshme Hyjnore para nesh!”³⁶

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

³⁶ I njëjti burim.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	5
-------------------	----------

E VËRTETA MBI ARROGANCËN

- Çfarë është arroganca?.....	8
- Vështrim mbi arrogancën në botë.....	11
- Arroganca dhe konflikti global.....	13
- Arroganca dhe masakrat.....	14
- Çfarë fshihet pas arrogancës?.....	18
- Përmbledhje e çështjes.....	20
- Qëllimet e arrogancës globale.....	21

MJETET E ARROGANCËS PËR TË KONTROLLUAR DHE PËR TË SUNDUAR BOTËN

- Prezantim.....	23
- Sundimi politik.....	24
- Mashtrimi politik i fuqive arrogante.....	26
- Presionet e jashtme të arrogancës.....	28
- Sundimi ekonomik.....	32
- Privimi i shteteve nga vetëmjaftueshmëria.....	33
- Shoqëria konsumatore është ëndrra dhe dëshira e arrogancës.....	36
- Hegjemonia kulturore:.....	39

a. Demoralizimi.....	39
b. Përhapja propagandistike brenda umetit.....	40
c. Promovimi dhe përhapja e parullave të rreme.....	43
d. Përpjekje për të shthurur brezin e ri.....	45

PËRBALLJA ME ARROGANCËN

- Prezantim.....	48
- Parullat dhe përballja me arrogancën.....	49
- Përballja me arrogancën është e natyrshme.....	51
- Si të përballemi me arrogancën?.....	53
a - Uniteti dhe bashkimi.....	53
b - Të jemi të guximshëm.....	54
c - Vigjilenca dhe kujdesi.....	55
d - Ruajtja e angazhimit fetar.....	55
PËRFUNDIM.....	57
PËRMBAJTJA.....	58

الإستكبار

آية الله العظمى السيد على الخامنئى (دام ظله الشريف)

تيرانا 2020

اسم الكتاب: الإستكبار

المؤلف: آية الله العظمى السيد علي الخامنئي (دام ظله الشريف)

المترجم: الحاج ولنت مريا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا